



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	03.04.2019
REFERENC-Ë:	18/5205/655/DMMU
PËR/ZA/TO:	"AL-Petrol" SH.P.K. Vragoli- Fushë Kosovë Stacion i karburanteve në Malishevë
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Z. Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm i MMPH-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për Leje Mjedisore



Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka shqyrtuar kërkesën për tu pajisur me Leje Mjedisore të kompanisë "AL-Petrol" SH.P.K. Vragoli- Fushë Kosovë, me nr. prot. 18/5205/655/DMMU, të datës: 13.09.2018.

MMPH pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, një sërë takimesh dhe vizitës në teren, bien vendimin i cili i bashkëngjitet kësaj letërpërcjellëse së bashku me Shtojcën:

1. Vendimi për Leje Mjedisore për kompaninë "AL-Petrol" SH.P.K. Vragoli- Fushë Kosovë, për veprimtarinë: stacion i karburanteve në Malishevë.
2. Shtojcë: Obligimet dhe detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 dhe Udhëzimi Administrativ për Leje Mjedisore Nr. 07/2017.

Me respekt



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning*

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Në bazë të nenit 31, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 dhe Udhëzimit Administrativ për Leje Mjedisore nr. 07/2017, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, bie këtë:

V E N D I M

Leje Mjedisore

Kompanisë "AL-Petrol" SH.P.K. Vragoli- Fushë Kosovë, për veprimtarinë: stacion i karburanteve në Malishevë.

Pas shqyrtimit të kërkesës për Leje Mjedisore, vizitës në teren dhe shqyrtimit të informatave shtesë për kompaninë "Al- Petrol" Sh.p.k. Vragoli- Fushë Kosovë, për stacionin e karburanteve me kapacitet të rezervuarët $V=4 \times 20.000$ litra për naftë dhe benzinë, si dhe rezervuarin me kapacitet $V=1 \times 10.000$ litra, për gazë të lëngëzuar naftor në ngastrën kadastrale P- 72310047-00520-2, zona kadastrale Malishevë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, vlerëson se operatori i plotëson kushtet teknike dhe mjedisore dhe merr Vendim për leshuarjen e Lejen Mjedisore.

Operatori obligohet:

- Të bënë monitorimin e vazhdueshëm të pajisjeve, respektivisht përmbushjes së kërkesave teknike;
- Të kontrollohet dhe mirëmbahet separatori i vajrave dhe lubrifikanteve;
- Nëse gjatë operimit do të ketë ndonjë prishje teknike e që mund të ketë ndikim në mjedis dhe shëndetin e popullatës, të njoftoj MMPH;

Faqe 2 nga 3

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë

Telefon: + 381 38-200-32-307

<http://www.ks-gov.net/mmph>, E-mail: zsp.mmph@ks-gov.net



- Për sistemin menaxhues mjedisore të këtë personin e profilit inxhinierik që është përgjegjës për mjedis;
- Pas përfundimit të veprimtarisë, operatori është i obliguar të kthej lokacionin në gjendjen e mëparshme.

Kjo Leje Mjedisore lëshohet për periudhën 5 (pesë) vjeçare, komfor nenit 31 paragrafi 2. të Ligjit për Mbrojtje e Mjedisit Nr. 03/L-25 dhe Udhëzimit Administrativ për Leje Mjedisore nr. 07/2017.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes së tij.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Nr.: 18/5205/ZSP/163/19 datë: 03.04.2019.

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komunës
3. DMMU-së
4. Inspektoratit
5. Kabinetit të Ministrit
6. Arkivit të MMPH-së





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ujërave / Department of Environment Protection and Water / Departament za Zivotnu Sredinu i Vodu

DATË/A:	03.04.2019
REFERENC-Ë:	18/5205/655/DMMU
PËR/ZA/TO:	Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Muhamet Malsiu, Drejtor i Departamentit për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Flet përcjellëse për lëshuarjen e Lejes Mjedisore

Bazuar në kërkesën e bërë nga kompania "AL-Petrol" SH.P.K. Vragoli- Fushë Kosovë, me nr. prot. 18/5205/655/DMMU, për tu pajisur me Leje Mjedisore për veprimtarinë: stacion i karburanteve në Malishevë, Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ujërave, ka vendosur sikurse në vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

Me respekt,

Faqe 1 nga 1